

## KUR MUND T'JU THËRRASIN SI DËSHMITAR NË LËNDË PENALE?

Si dëshmitar mund të thirrëni në rast se organet kompetente (prokuroria dhe gjykata) konsiderojnë se keni njohuri dhe se me gjasë mund të jepni njoftim për veprën penale dhe kryerësin dhe për rrethanat tjera të rëndësishme. Si për shembull, nëse e keni parë se kur ka ndodhur vepra penale, nëse keni dëgjuar diçka në lidhje me të, e të ngjashme.

## NË ÇFARË MËNYRE DO T'JU THËRRASIN?

Me ftesë me shkrim ku është shënuar emri dhe mbiemri Juaj, koha dhe vendi kur dhe ku duhet të vini, lënda penale në lidhje me të cilën Ju thërrasin, si dhe paralajmërimi për pasojat nëse nuk i përgjigjeni ftesës. Në ftesë do të jetë theksuar se Ju thërrasin në cilësi të dëshmitarit.

## A E KENI PËR OBLIGIM TË PARAQITENI NË FTESËN TË CILËN E KENI MARRË?

Po, gjithmonë kur do të merrni një ftesë të këtillë, jeni të obliguar të paraqiteni para organit që Ju fton, në kohën dhe vendin e shënuar në ftesë. Mirëpo, në disa rrethana, si për shembull për shkak të pleqësisë, sëmundjes ose gjytmësive të rënda trupore të cilat ua pamundësojnë lëvizjen, mund të merreni në pyetje edhe në shtëpinë Tuaj ose në ndonjë vend tjetër ku gjendeni.

## ÇKA NËSE NUK I PËRGJIGJENI FTESËS? A MUND TË KENI NDONJË PASOJË?

Në qoftë se jeni të thirrur në mënyrë të rregullt, dhe nuk i përgjigjeni ftesës pa e arsyetuar me këtë rast mungesën Tuaj, mundet me urdhër gjyqësor t'ju sjellin me

detyrim, e gjykata mund t'ju dënojë edhe me dënim në para.

Nëse jeni të penguar për të ardhur, duhet me kohë ta njoftoni organin që Ju ka thirrë. Shkaqet që e arsyetojnë mungesën mund të jenë të ndryshme, mirëpo arsyeshmërinë e tyre gjithsesi e vlerëson organi që e mban procedurën.

## A DUHET PATJETËR TË PËRGJIGJENI NË PYETJET?

Po, në pyetjet e parashtruara patjetër duhet të përgjigjeni. Nëse refuzoni të përgjigjeni në pyetjet mund të dënoheni me para më së shumti dy herë, e në qoftë se edhe pas dënimit të dytë me para refuzoni të dëshmoni, gjykata mund t'ju shqiptojë dënim me burg deri në 30 ditë.

Ndonjëherë, nëse kjo kërkohet prej jush, dhënia e deklaratës nënkupton edhe obligim që t'i njihni sendet ose personat që do t'ju tregohen.

## A DUHET TË PËRGJIGJENI ME VËRTETËSI NË PYETJET E PARASHTRUARA?

Po, në pyetjet e parashtruara jeni të obliguar të përgjigjeni me vërtetësi, pa heshtur asgjë nga ajo që e dini në lidhje me veprën penale dhe autorin. Do të konsiderohet se keni heshtur ndonjë gjë, atëherë kur nuk e keni treguar gjithë atë që e dini, gjegjësisht kur deklarata Juaj nuk paraqet pasqyrë të plotë të fakteve që Ju i keni vërejtur dhe i keni mbajtur mend. Dëshmia është e rrejshme atëherë kur nuk është në përputhje me njohuritë Tuaja për ngjarjen dhe në përgjithësi për faktet që i nënshtrohen dëshmimit. Nëse jepni dëshmi se nuk dini asgjë për atë që i nënshtrohet dëshmimit, për shembull, se nuk keni parë asgjë, se nuk keni dëgjuar, e në fakt keni parë dhe keni dëgjuar, poashtu konsiderohet dhënie e

dëshmisë së rrejshme.

Mbani mend se dhënia e dëshmisë së rrejshme gjatë dëshmimit është veprë penale, që do të thotë se nëse jepni dëshmi të rrejshme do të përgjigjeni penalisht!

## A KENI TË DREJTË TË REFUZONI TË PËRGJIGJENI NË NDONJËRËN NGA PYETJET E PARASHTRUARA?

Në raste të caktuara mund të refuzoni të përgjigjeni në ndonjë pyetje konkrete. Ato raste janë: në qoftë se me përgjigjen në pyetjen e caktuar do ta ekspozonit vetveten ose ndonjë të afërm në turp të madh, dëm të konsiderueshëm material ose ndjekje penale.

## ÇFARË PYETJESH NUK GUXOJNË T'U PARASHTROHEN?

Pyetjet të cilat kanë të bëjnë me jetën Tuaj seksuale dhe prirjet seksuale, përcaktimin politik dhe ideologjik, prejar-dhjen racore, nacionale dhe etnike, kriteret morale dhe rrethanat e tjera të veçanta personale dhe familjare, përveç me përjashtim, nëse përgjigjet në pyetjet e tilla janë të lidhura me shpjegimet e karakteristikave të rëndësishme të veprës penale.

## A EKZISTOJNË KATEGORI TË PERSONAVE QË NUK ËSHTË PATJETËR TË DËSHMOJNË?

Në qoftë se jeni bashkëshort, përkatësisht shok jashtëmartesor, nëse jeni farefis i të akuzuarit nga gjaku në vijë të drejtë, farefis i të akuzuarit në vijë anësore deri në shkallën e tretë, si dhe farefis sipas krushqisë përfundimisht deri në shkallën e dytë, ose adoptues dhe i adoptuar i të akuzuarit, atëherë keni për obligim vetëm të paraqiteni në ftesën, por

nuk e keni për obligim të jepni dëshmi.

Obligim për t'u paraqitur në ftesën keni për shkak se organi i procedurës duhet së pari ta konstatojë identitetin Tuaj dhe raportin Tuaj me të akuzuarin, e pastaj të vendoset se a bëni pjesë në kategorinë e personave që janë të liruar nga obligimi për të dëshmuar.

Sapo të përcaktohet raporti Juaj me të akuzuarin, edhe atë para se të merreni në pyetje, organi do t'ju paralajmërojë se nuk jeni të obliguar të dëshmoni. Vendimi se a do të dëshmoni ose jo, është i Juaji.

## A EKZISTOJNË KATEGORI TË PERSONAVE QË NUK MUND TË DËSHMOJNË?

Nuk mund të dëshmoni nëse jeni:

- person i cili me deklaratën e tij do ta cenonte detyrën e ruajtjes së sekretit shtetëror dhe ushtarak, derisa organi kompetent nuk Ju liron nga ajo detyrë;
- mbrojtës i të akuzuarit për atë që ua ka besuar i akuzuari si mbrojtës i tij, përveç nëse vet i akuzuari nuk kërkon prej Jush të dëshmoni;
- person i cili me deklaratën e tij do ta cenonte detyrën për ruajtjen e sekretit afarist në lidhje me atë që e keni mësuar gjatë kryerjes së profesionit tuaj (predikues fetar, avokat dhe mjek), përveç nëse jeni të liruar nga ajo detyrë;
- person i mitur, i cili duke marrë parasysh moshën e tij dhe zhvillimin shpirtëror nuk është i aftë që ta kuptojë rëndësinë e të drejtës së tij se nuk është patjetër të dëshmojë dhe
- person i cili për shkak të sëmundjes së tij shpirtërore ose trupore, gjegjësisht moshës së tij, aspak nuk është në gjend-

je që të dëshmojë.

### SI DUKET MARRJA NË PYETJE E DËSHMITARIT?

Në fillim do t'ju paralajmërojnë se jeni të obliguar ta thoni të vërtetën dhe se nuk guxon të heshtni asgjë dhe se dhënia e dëshmisë së rrejshme paraqet veprë penale. Do t'ju këshillojnë edhe për atë se në cilat pyetje nuk jeni të obliguar të përgjigjeni.

Poashtu, do t'ju pyesin edhe për të dhënat Tuaja personale, si dhe për raportin Tuaj me të akuzuarin dhe të dëmtuarin. Pastaj, pasojnë pyetje në lidhje me veprën penale dhe kryerësin për të cilat mbahet procedura.

### ÇKA NËSE KENI FRIKË SE ME DËSHMINË TUAJ DO TA RREZIKONIT JETËN TUAJ OSE JETËN E NDONJË TË AFËRMI TUAJ?

Nëse keni frikë se me dhënien e dëshmisë ose me përgjigjen në ndonjë pyetje të caktuar do ta vini vetveten Tuaj ose ndonjë person të afërt me Ju në rrezik serioz për jetën, shëndetin ose integritetin fizik, mund ta mohoni dhënien e dëshmisë ose paraqitjen e të dhënave Tuaja personale derisa të sigurohen kushtet për mbrojtjen Tuaj.

Prokurori publik, gjegjësisht gjykata çmojnë se a ka me të vërtetë baza për frikën Tuaj dhe nëse ka do t'ju sigurojnë mbrojtje. Mbrojtja mund të përbëhet nga mënyra e veçantë e marrjes në pyetje dhe nga zbatimi i masave të tjera për mbrojtje. Kështu për shembull, do t'u caktojnë pseudonim, mund t'ju marrin në pyetje me ndihmën e pajisjeve për transmetim të fotografisë dhe zërit, me ç'rast fytyra dhe zëri juaj do të ndryshohen,

nuk guxojnë t'ju parashtrojnë pyetje me të cilat do të zbulohet identiteti Juaj, vendbanimi, punësimi etj.

### ÇKA NËSE VETË MARRJA NË PYETJE MUND TË LË PASOJË TË DËMSHME PËR SHËNDETIN TUAJ PSIKIK?

Nëse është kështu, atëherë bëni pjesë në grupin e ashtuquajtur të dëshmitarëve veçanërisht të cenueshëm. Arsyë për këtë mund të jenë rrethanat e ndryshme, si për shembull: moshë Juaj, gjendja shëndetësore, natyra ose pasojat nga vepra penale etj. Në atë rast, pyetjet mund t'ju parashtrohen me ndihmën e psikologut, punëtorit social ose ndonjë personi tjetër profesional.

# ÇKA DUHET TË DINI NËSE JENI DËSHMITAR NË LËNDË PENALE?